



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, nenit 6.2 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe nenit 19.1 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës i Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2014, miratoi:

VENDIM

PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Lejohet ndërrimi i destinimit të përherëshëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 633-0 kultura – kullosë kl. 2 vendi i quajtur, Livadhe në sipërfaqe prej 6779 m², Zona kadastrale Sfeqël, Certifikata pronësore nr. 17-2043 të datës 14.01.2015, në pronësi të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Paluajtshmëria përkatëse shfrytëzohet në funksion të realizimit të kontratës të lidhur më 15 dhjetor 2014 në mes të Komunës së Podujevës dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, për "Themelimin e Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në Llap dhe Gollak të produkteve bujqësore".

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 02 – 320- 70409
Podujevë,
31 korrik 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi